

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Per Aktivitetin:

**"INSTALIM PER ASGJESIMIN E MBETJEVE TE
RREZIKSHME SPITALORE ME ANE TE
INCENERIMIT"**

Vendodhja : Nj.Ad. Fushë-Kuqe, Bashkia
Kurbin. Qarku Lezhë.

Kërkues: "V.A.L.E RECYCLING" Sh.p.k

Hartoi raportin:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu

Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)



A purple ink signature of Altin Ahmeti.

A purple ink signature of Elidiana Shehu.

Permbajta e Tabeles

1. HYRJE.....	2
2. PERSHKRIM I PERMBLEDHUR I KUADRIT LIGJORE MJEDISORE DHE INSTITUCIONAL.....	2
3. PERSHKRIMI I QELIMIT TE PROJEKTIT	3
4. PLANIMETRIA E VENDODHJES SE PROJEKTIT	4
5. PERSHKRIMI I PROCESVEVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE.....	5
5.1. Të dhënat për Inçeneratorin (tip).....	5
5.2. Karakteristikat e incineratorëve pirolitikë (WFS-50).....	6
5.3. Kapaciteti i Incineratorit (tip)	6
5.4. Përparësia.....	7
5.5. Karakteristikat kryesore	7
5.6. Procesi i punës	7
5.7. Skica e ndërtimit të Incineratorit	9
6. PERSHKRIMI I CILESISE SE MJEDISIT DHE NDIKIMEVE EKZISTUESE	9
6.1. Cilesia e ujrave	9
6.2. Cilesia e ajrit.....	9
6.3. Administrimi i mbetjeve	10
3.3.4 Presione kryesore te mjedisit.....	10
7. Pershkrimi i Mjedisit	10
7.1. Mjedisi fizik	10
7.1.1. Gjeologjia	10
7.1.2. Gjeomorfologjia	11
7.1.3. Tokat.....	11
7.1.4. Ujërat.....	11
7.1.5. Klima.....	11
7.2. Mjedisi biologjik.....	12
7.2.1. Flora.....	12
7.2.2. Fauna	12
7.2.3. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.....	12
8. PERSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR	13
8.1. Analiza e ndikimeve të mundshme sociale dhe në mjedis.....	13
8.2. Ndikimet ne mjedis të projektit të propozuar për trajtimin e mbetjeve.....	13
8.3. Ndikimet sociale të projektit të propozuar për trajtimin e mbetjeve	16
9. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT.....	17

1. HYRJE

Për shkak të zhvillimit ekonomik, industrializimit dhe rritjes së popullsisë, kërkesat për lëndë të para dhe produkte nga më të ndryshmet vijnë duke u rritur, ndërkohë që burimet natyrore dhe energjia e shfrytëzueshme vijnë duke u pakësuar. Një tjetër problem serioz për tu përballur është prodhimi i mbetjeve të ndryshme, e në vecanti ato të rrezikshme të prodhuara nga konsumi i materialeve, që kanë shkaktuar ndotje serioze në mjedis, duke rrezikuar mbijetesën e qënieve të gjalla. Ndër mbetjet urbane dhe industriale me ndikim të rëndësishëm në mjedis janë metalet, plastika, goma, vajrat lubrifikantë të përdorur, mbetjet spitalore, mbetjet industriale, përbërje të ndryshme kimike në fushën e industrisë, bujqësisë, etj.

Mungesa e një infrastrukture për grumbullimin e seleksionuar të mbetjeve në përgjithësi, mungesa e landfilleve të mirëfilltë në zona të ndryshme të vendit dhe sidomos mungesa e investimeve në fushën e përpunimit dhe riciklimit të këtyre mbetjeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të ndotjes, kryesisht në lumenjtë, përrrenjtë dhe grykëderdhejet/deltat e lumenjve. Një ndër kontribuesit e rëndësishëm në ndotjen e mjedisit janë edhe mbetjet në fushën e mjeksisë të cilat janë cilësuar si të rrezikshme për vetitë e tyre infektive dhe të përbërjes organike të mbetjeve.

Investimi dhe aplikimi i teknologjisë ricikluese / asgjësuese do të rriste sigurinë dhe kushtet e jetesës, si dhe interesin ekonomik të grumbullimit dhe të menaxhimit të këtyre mbetjeve si edhe do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të përhapura në mjedis të ndryshme.

Projekti në vlerësim do të ndërtojë / instalojë një incinerator më qëllim asgjësimit të mbetjeve spitalore dhe farmaceutike nëpërmjet procesit të incinerimit / djegies në temperatura të larta.

Shoqëria ka eksperiencë në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Shtimi i instalimeve krijon mundësinë e shtimit të llojit të mbetjeve të rrezikshme që nuk trajtohen me autoklave nëpërmjet metodave që minimizojnë ndotjen mjedisore.

Aktivitetin e saj kompania kërkon ta zgjerojë duke rritur llojin e mbetjeve të rrezikshme (spitalore dhe farmaceutike) për asgjësim nëpërmjet metodës së incinerimit. Gjatë kësaj veprimtarie do të kryhet asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe farmaceutike.

2. PERSHKRIM I PERMBLEDHUR I KUADRIT LIGJORE MJEDISORE DHE INSTITUCIONAL

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si më poshtë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri. Ligji Për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Së fundmi këto ligje janë përafuar plotësisht me ligjet e Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit dhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Sipas Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis ” shtojca II ky projekt duhet të nënshtrohet procedurës së miratimit të VNM.

Bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, në Aneksin Nr.1, ky projekt klasifikohet në listën e aktiviteteve që duhet të pajisen me leje mjedisore të tipit B për të gjitha instalimet.

3. PERSHKRIMI I QELLIMIT TE PROJEKTIT

Për shkak të zhvillimit ekonomik, industrializimit dhe rritjes së popullsisë, kërkesat për lëndë të para dhe produkte nga më të ndryshmet vijnë duke u rritur, ndërkohë që burimet natyrore dhe energjia e shfrytëzueshme vijnë duke u pakësuar. Një tjetër problem serioz për tu përballur është prodhimi i mbetjeve të ndryshme, e në vecanti ato të rrezikshme të prodhuara nga konsumi i materialeve, që kanë shkaktuar ndotje serioze në mjedis, duke rrezikuar mbijetesën e qënieve të gjalla. Ndër mbetjet urbane dhe industriale me ndikim të rëndësishëm në mjedis janë metalet, plastika, goma, vajrat lubrifikantë të përdorur, mbetjet spitalore, mbetjet industriale, përbërje të ndryshme kimike në fushën e industrisë, bujqësisë, etj.

Mungesa e një infrastrukture për grumbullimin e seleksionuar të mbetjeve në përgjithësi, mungesa e landfilleve të mirëfilltë në zona të ndryshme të vendit dhe sidomos mungesa e investimeve në fushën e përpunimit dhe riciklimit të këtyre mbetjeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të ndotjes, kryesisht në lumenjtë, përrenjtë dhe grykëderdhejet/deltat e lumenjve. Një ndër kontribuesit e rëndësishëm në ndotjen e mjedisit janë edhe mbetjet në fushën e mjeksisë të cilat janë cilësuar si të rrezikshme për vetitë e tyre infektive dhe të përbërjes organike të mbetjeve.

Investimi dhe aplikimi i teknologjisë ricikluese / asgjësuese do të rriste sigurinë dhe kushtet e jetesës, si dhe interesin ekonomik të grumbullimit dhe të menaxhimit të këtyre mbetjeve si edhe do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të përhapura në mjedise të ndryshme.

Projekti në vlerësim do të ndërtojë / instalojë dy incinerator më qëllim asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe farmaceutike nëpërmjet procesit të incinerimit / djegies në temperatura të larta.

Shoqëria ka eksperiencë në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Shtimi i instalimeve krijon mundësinë e shtimit të llojit të mbetjeve të rrezikshme që nuk trajtohen me autoklave nëpërmjet metodave që minimizojnë ndotjen mjedisore.

Aktivitetin e saj kompania kërkon ta zgjerojë duke rritur llojin e mbetjeve të rrezikshme (spitalore dhe farmaceutike) për asgjësim nëpërmjet metodës së incinerimit. Gjatë kësaj veprimtarie do të kryhet asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe farmaceutike.

4. PLANIMETRIA E VENDODHJES SE PROJEKTIT

Vendi i propozuar për zbatimin e këtij projekti është një ndërtesë egzistuese e të njëjtës kompani në afërsi të fshatit Gurrëz ,NJAD Fushë Kuqe, në Rrethin e Kurbinit, pjesë administrative e Prefekturës së Lezhës.



Ortofoto e zones ne vleresim

Koordinatat e objektit ku do të instalohet incineratori

Nr	X	Y
1	4384964	4615576
2	4384975	4615572
3	4384972	4615563
4	4384977	4615561
5	4384974	4615552
6	4384968	4615551
7	4384965	4615542
8	4384953	4615550
9	4384954	4615557
10	4384957	4615556

5. PERSHKRIMI I PROCESVEVE NDERTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

Incinerimi / djegia është një proces oksidimit në të thatë dhe në temperaturë të lartë që degradon mbetjet organike dhe të djegshme në lëndën inorganike dhe të padjegshme si edhe rezulton në një reduktim shumë të madh të vëllimit dhe peshës së mbetjeve. Ky proces zakonisht zgjidhet për të trajtuar mbetjet që nuk mund të riciklohen, ripërdoren ose depozitohen në një vend depozitimi / landfill.

Djegia e komponimeve organike prodhon kryesisht shkarkime të gazta, duke përfshirë avull uji, dioksid karboni, okside të azotit dhe substanca toksike të caktuara (p.sh. metale, acide halogjene) dhe lëndë të ngurt pezull, plus mbetjet solide në formë hiri. Nëse kushtet e djegies nuk kontrollohen siç duhet, do të prodhohet edhe monoksidi toksik i karbonit. Hiri i prodhuar nga procesi gjithashtu përmbanë komponime toksike, të cilat duhet të trajtohen për të shmangur efektet negative në shëndet dhe mjedis.

Të gjitha llojet e incineratorëve, nëse funksionojnë siç duhet, eliminojnë patogjenët dhe bëjnë djegie të plotë të mbetjeve. Megjithatë, disa lloje të mbetjeve spitalore, farmaceutike ose kimike, kërkojnë temperatura më të larta për shkatërrim të plotë.

Temperaturat e larta operuese dhe pastrimi i gazrave të shkarkimit kufizojnë ndotjen atmosferike dhe erërat e prodhuara nga procesi i djegies. Incineratori që Subjekti do të instalojë është Incinerator Piroolitikë dhe bazohet në teknologjinë Japoneze. Përbëhet nga dy dhomat e djegjes, depozita e lëndës djegëse, kutia e kontrollit elektrik, 2 brucatorët / djegësit, oxhaku me diametër të jashtëm 400 mm si dhe ka një instalim 3D ku mund të shikohet procesi i djegies. Dhoma pirolitike dhe e post-djegies janë të përbëra prej çeliku me një rreshtim të brendshëm të tullave të forta, rezistente ndaj temperaturave të larta, mbetjeve korrozive ose gazit që gjenerohet gjatë procesit të djegies. Incineratori është një pajisje kompakte që nuk ka nevojë për sipërfaqe të madhe toke. Ky impiant siguron shkarkim të ulët të dioxinave, niveli i hirave është më pak se 5%, voltazhin e ka të rregullueshëm që do të thotë se në varësi të kërkesës ndryshohen ngarkesat. Realizon një djegie totale nëpërmjet dy dhomave të djegies në temperature njëra dhomë (dhoma pirolitike) 600 °C – 900 °C dhe tjetra (dhoma e post-djegies) 900 °C - 1200 °C. **Kapaciteti trajtimit per nje impiant është 30-50 kg / cikël.**

Gjithsej ne kete ambient te ketij aktiviteti do te instalohen dy impiante te tilla .

Mbetjet digjen cdo ditë që do të thotë nuk ka nevojë për kapacitete të mëdha.

5.1. Të dhënat për Incineratorin (tip)

- Modeli i incineratorit WFS – 50
- Kapaciteti në cikël 30-50 kg / cikël (realizon 3-6 cikle në ditë)
- Dimensioni i incineratorit 1.8 x 1.15 x 3 m
- Pesha e incineratorit 4000 kg
- Tensioni i pajisjes 380 V/ 220V
- Ventiluesi i ajrit 0.37 kw
- Diametri i jashtëm i oxhakat 280 mm
- Përmasat e portës hyrëse 620 x 800 mm
- Konsumi i lëndës djegëse:
 - I. Brucatori në dhomën e parë; 0.11 kw, 4 -10 kg /orë
 - II. Brucatori në dhomën e dytë; 0.11 kw, 4 - 10 kg/ore

Incineratorët pirolitikë me dy dhoma janë më të besueshëm dhe më të zakonshëm për trajtimin e mbetjeve spitalore, e quajtur edhe djegia e kontrolluar me ajrër ose djegia në dy dhoma. Karakteristikat kryesore të incineratorëve pirolitikë, të dizajnuar veçanërisht për trajtimin e mbetjeve spitalore janë:

5.2. Karakteristikat e incineratorëve pirolitikë (WFS-50)

I përshtatshëm për kategoritë e mëposhtme të mbetjeve:

- Mbetjet infektive (duke përfshirë kontenierët) dhe mbetjet patologjike
-trajtim efikas; eliminimin e të gjithë patogjenëve.
- Mbetjet farmaceutike dhe kimike
-shkakton shpërbërjen e shumicës së mbetjeve; megjithatë, vetëm sasi të vogla (p.sh. 5% e ngarkesës totale të mbetjeve) të këtyre mbetjeve duhet të digjen në këtë proces.
- Mbetjet citotoksike

Vlera e ulët e ngrohjes së mbetjeve duhet të tejkalojë 3500 kcal / kg (14650kJ / kg).

I papërshtatshme për mbetjet e mëposhtme:

- Mbetjet spitalore jo të rrezikshme të ngjashme me mbetjet urbane
- Mbetjet gjenotoksike
-trajtimi ndoshta nuk është efikas.
- Mbetjet radioaktive
-trajtimi nuk ka efekt në vetit radioaktive dhe mund të shpërndajë rrezatim.

Mbeturinat që nuk duhet të digjen:

- Kontenierët nën presion;
-mund të shpërthejnë gjatë djegies dhe të shkaktojnë dëme në pajisje.
- Plastika të halogjenizuara si PVC;
-Gazrat e shkarkimit mund të përmbajnë acide dhe dioksina klorhidrik.
- Mbetjet me përmbajtje të lartë të metaleve të rënda;
-djegia do të shkaktojë emëtime të metaleve toksike (p.sh. plumbi, kadmiumi, merkuri) në atmosferë.
- Sasi të mëdha të mbetjeve kimike reaktive;
- Kripërat e argjendta dhe mbetjet fotografike ose radiografike;

Temperatura e djegies:

- Në dhomën pirolitikë 600 - 900 °C;
- Në dhomën e post djegies 900 - 1200 °C;

5.3. Kapaciteti i Incineratorit (tip)

Kapacitetet e disponueshme shkojnë nga 200 kg / ditë në 10 ton / ditë.

Incineratori që subjekti do të instalojë ka një kapacitet 30-50 kg / cikël.

5.4. Përparësia

- Jetëgjatësi e gjatë
- Operacioni tërësisht i mbyllur
- I përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve infektive
- Shmang ndotjen sekondare
- Funksionim i thjeshtë

5.5. Karakteristikat kryesore

1. Fillimi i procesit të incinerimit nxitet nga përdorimi i lëndës djegëse gas / naftë, sipas nevojave të klientëve. Në rastin konkret lënda djegëse është naftë.
2. Procesi i gazifikimit përdoret për djegjen e shiringës, mbeturinave të letrës, fashave, pambukut absorbues dhe mbetjeve të tjera mjeksore.
3. Mbetjet e përditshme mund të digjen me gazifikim.
4. Teknologjia e këtij modeli incineratori, siguron një standard të ulët shkarkimi të pluhurit (më i ulët se standardi ndërkombëtar).
5. Operacioni tërësisht i mbyllur është i përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve infektive për të shmangur ndotjen sekondare.
6. Nuk ka shkarkime të tymit të zi / të dukshëm. Shkarkimet e gazeve janë pa aromë dhe jo të dukshme.

5.6. Procesi i punës

Arritja e kushteve optimale të djegies është shumë e rëndësishme për të realizuar një shkatërrim të plotë të mbetjeve pa prodhuar sasi të konsiderueshme të hirit ose gazeve të dëmshme (p.sh. monoksidi i karboni, dioksinat, furanet, metalet e rënda, etj). Temperatura kritike e djegies, koha e qëndrimit të mbeturinave brënda në dhomën pirolitike, turbulenca e gazit dhe sasi e nevojshme e ajrit janë disa nga faktorët që duhen pasur parasysh për të realizuar një djegie të plotë të mbetjeve.

Procesi i punës së incineratorit do të monitorohet nga një staf teknik i trajnuar, i cili është në gjëndje të mbajë pajisjen në kushtet e kërkuara (optimale) për të patur një djegie të plotë të mbetjeve, duke kontrolluar sistemi manualisht nëse është e nevojshme. Zhvillimi i një procesi korrekt të djegies së mbetjeve është shumë i rëndësishëm, jo vetëm për të maksimizuar efikasitetin e trajtimit të mbetjeve dhe për të minimizuar ndikimet në mjedis nga shkarkimet që vijnë si rezultat i një procesi të pakontrolluar të djegies së mbetjeve, por edhe për të zvogëluar kostot e mirëmbajtjes së pajisjes / incineratorit.

Stafi teknik i pajisur me të gjitha mjetet mrojtëse do të bëjë mbushjen e dhomës pirolitike të incineratorit me konteniret ose qeset e përshtatshme për mbetjet spitalore nëpërmjet portës e cila është në përmasat e duhura për të bërë ngarkimin e mbetjeve të paketuara. Duhet pasur parasysh që të mos kemi një tejmbushje të dhomës pirolitike mbi kapacitetin maksimal të saj.

Pas procesit të mbushjes së dhomës pirolitike stafi sigurohet që porta është mbyllur dhe fillimisht bënë ndezjen e brucatorit të lëndës djegëse (nafta) në dhomën e post-djegiës dhe me pas bëhet ndezja e brucatorit në dhomën pirolitike. Koha e qëndrimit të mbetjeve në dhomën pirolitike është 1 orë dhe temperatura arrin deri në 900 °C.

Në këtë dhomë kemi zhvillimin e procesit të gazifikimit të përbërësve të ndryshëm të mbetjeve në një mënyrë të tillë që të marrë një përzierje të gazit të djegshëm me një vlerë kalorike. Kjo fazë e djegies zhvillohet në sasi të kufizuara të ajrit dhe në temperatura të ulëta për të kufizuar sa më shumë të jetë e mundur fillimin e djegies së vërtetë. Në këtë fazë kemi gjenerimin e gazeve sintetike si edhe hirit fundor.

Gazet e gjeneruara kalojnë në dhomën e post-djegies ku bëhet oksidimi i plotë i tyre në temperatura të larta që shkojnë 1200 °C dhe në tepricë oksigjeni (sasi e madhe e ajrit). Koha e qëndrimit të gazeve në dhomën e post-djegies është 2 sekonda dhe pas procesit të oksidimit gazet kalojnë në dhomën e filtrimit.

Pas filtrimit gazet kalojnë në oxhak për tu shkarkuar në atmosferë. Sipas testeve që ka kryer kompania prodhuese, gazet e shkarkuara në atmosferë janë brenda normave të lejuara për shkarkimet në ajër sipas legjislacionit në fuqi. Pas këtij procesi pajisja fiket dhe lihet të ftohet. Pas ftohjes hapet porta e nxjerrjes së hirit i cili ambalazhohet dhe trajtohet konform ligjislacionit në fuqi.


I gjithë procesi i incinerimit të mbetjeve kontrollohet dhe monitorohet nga stafi teknik nëpërmjet panelit të kontrollit në të cilin shfaqen në mënyrë të vazhdueshme parametrat dhe kushtet e funksionimit të pajisjes (temperatura, rrjedhja e ajrit, rrjedha e karburantit etj.).

Gjatë zhvillimit të procesit të djegies duhet mbajtur një ekuilibër i kujdesshëm operacional mes dy dhomave të djegies. Në rastet se kjo nuk arrihet nga stafi teknik do të kemi pasoja të tilla si:

- Djegia e shpejtë e mbetjeve do të rrisë shpejtësinë e lëvizjes së gazeve dhe do të ulë kohën e qëndrimit nën minimumin e dëshiruar prej 2 sekondave në dhomën e post-djegies. Kjo do të rezultojë në oksidim / djegie të pjesshme dhe jo të plotë të gazeve dhe rritjen e sasisë së hirit fluturues dhe lëndës së ngurtë pezull, të cilat mund të bllokojnë sistemin dhe të çojnë në probleme të mëdha të mirëmbajtjes.
- Djegia pirolitike e mbetjeve shumë e ngadaltë, do të reduktojë shpejtësinë e lëvizjes së gazeve dhe do të rrisë kohën e qëndrimit në dhomën e post-djegies. Kjo mund të zvogëlojë ndotjen e ajrit, por do të rezultojë në një kapacitet më të ulët djegieje dhe konsum më të lartë të lëndës djegëse.

Procesi kryhet me cikël të mbyllur duke shmangur rrezikun nga infeksionet e mundshme dhe shmang infeksionet dytësore.

5.7. Skica e ndërtimit të Incineratorit



6. PERSHKRIMI I CILESISE SE MJEDISIT DHE NDIKIMEVE EKZISTUESE

6.1. Cilesia e ujrave

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor për lumen Mat, duke përfqësuar gjithë gjatësinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, në rrjedhjen e mesme dhe në rrjedhjen e poshtme është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Klasifikohet si një basën me cilësi shumë të mirë, cilësi e pare në të gjitha stacionet e monitoruara.

Ujërat e këtij baseni kanë përmbajtje të larte të sasisë së oksigjenit të tretur që varion nga 8.6-9.3mg/l (norma >7)

6.2. Cilesia e ajrit

Mbështetur në Ligjin Nr.10 266, datë 15.04.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8897, datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", në VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe Proçedurat për hartimi dhe zbatimin e Programit Kombëtar për monitorimin e mjedisit", nga AKM është realizuar monitorimi i cilësisë së ajrit urban për treguesit kryesorë të cilësisë se ajrit urban si: PM10, PM2.5, NO2, SO2, O3, CO dhe BTEX.

Referuar zones ku do te zhvillohet projekti themi se vlerat e ndotesve te ajrit jane brenda parametrave te jeluar pasi nuk kemi qarkullim te dendur te automjetve si dhe nuk jane evidentuar industri prodhuese.

Ndersa ne rang vendi, po ti referohemi PM10 dhe NO2 të cilët janë tregues me burim ndotje trafikun dhe për arsyen se të dy kanë tejkalime të dukshme të vlerave të monitoruar në vitin 2015 krahasuar me 2014 theksojmë se ndoshta ky tejkalim është për shkak të rritjes së trafikut në qytetet e medha.

6.3. Administrimi i mbetjeve

Mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit të njerëzve nga ndotja dhe dëmtimi, që shkaktohen nga mbetjet e ngurta (shtëpiake, tregtare) dhe inerte (ndërtimi dhe shkatërrimi), kërkon zbatimin e legjislacionit të miratuar në fushën e mbetjeve në të cilin janë përcaktuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe në zvoglimin e ndikimeve të tyre në mjedis.

Sipas Agjensise Europiane te Mjedisit ne Nentor 2013 sasia e Mbetjeve te kujdesit shendetesor zinet 0,17% te sasise se mbetjeve totale, me gjithsej 4 ton/dite ose 1460 ton /vit Mbejetje Kujdesit shendetesor.

Sfidat në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve janë:

- Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Integruar të menaxhimit të mbetjeve;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për trajtimin e mbetjeve; si dhe
- Bashkërendimi administrativ ndërmjet strukturave qendrore dhe vendore për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe qartësimin funksional të tyre.

3.3.4 Presione kryesore te mjedisit

Zona ne te cilen do te ushtrohet aktiviteti eshte nje zone mikse industriale dhe urbane. Presioni kryesor ne lidhje me mjedisin ne kete zone jane shkarkimet e mbetjeve ne ujrat e lumit Mat si edhe aktiviti i shfrytezimit te inerteve ne kete lum.

7. Pershkrimi i Mjedisit

Instalimi i dy pajisjeve per asgjесimin e mbetjeve tw rrezikshme me incinerim (Incinerator model WFS – 50, pwr trajtimin e mbetjeve tw rrezikshme spitalore qw i nwnshtrohen procesit tw djegies nw temperaturat 600 °C – 900 °C nw dhomwm pirolitike dhe 900 °C - 1200 °C nw dhomwn e post-djegies.) do tw instalohen nw njw godinw ekzistuese me vendodhje nw në afërsi të fshatit Gurrëz ,NJAD Fushë Kuqe, në Bashkinë e Kurbinit, pjesë administrative e Prefekturës së Lezhës.

7.1. Mjedisi fizik

7.1.1. Gjeologjia

Zona ku do të përqëndrohet aktiviteti per trajtimin e mbetjeve, nga pikëpamja gjeologo-tektonike bën pjesë në Ultësirën Pranadriatike. Kjo zone ndërtohet nga shkëmbinj dhe dhera të moshave gjeologjike nga Triasiku deri në Kuarternar që i përkasin zonës tektono faciale “Mirdita”, Nenzonës “Krasta”, zonës “Kruja” dhe “Ultësirës Pranë Adriatike”(UPA).

Referuar testit rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh) shkëmbinj të ndahen në tre grupe:

- shkëmbinj të fortë;
- shkëmbinj mesatare;
- shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është

Referuar kriterëve si kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm (ϕ) dherat janë klasifikuar në tre grupe:

- dhera pa lidhje kohezionale
- dhera me lidhje kohezionale
- dhera me veti të veçanta

7.1.2. Gjeomorfologjia

Bashkia e Kurbinit shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë së Mesme në zonën midis lumenjve Mat në veri dhe Drojë në jug. Nga veriu kufizohet me bashkitë e Lezhës dhe të Mirditës, në lindje me bashkinë e Matit, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik. Pjesa lindore e kësaj krahine është pothuajse krejt male në të cilën dallohen dy vargmale të cilat ecin pothuajse paralel me njëri tjetrin, njëri prej të cilëve ai lindor është vargmali i Skënderbeut (22 km gjatësi), ndërsa tjetri vargmali perëndimor është vargmali Krujë - Dajç. Dy vargmalet i ndan në mes lumi i Hurdhazës që buron nga Mali i Skënderbeut në Vinjollë, kurse pjesa perëndimore është fushë. Mali i Skënderbeut nis nga Shkopeti kalon në majën e Mëllezës (1123 m) e vijon me majën e Hithit 1316 m, duke mbërritur pikën më të lartë në majën e liqenit (1724 m). Vargmali perëndimor ka pikën më të lartë në majën e Kunorës sipër Milotit (745 m) e ndjekuar afër saj nga maja e Sukës (675 m). Kurbini ndodhet 45 km larg kryeqytetit, 65 km nga porti i Durrësit, 20 km nga porti i Shëngjinit dhe 40 km larg aeroportit Kombëtar Nënë Tereza. Qyteti i Milotit është një lidhëse me të gjithë krahinat e Shqipërisë së Veriut e Verilindjes si kryqëzim i rrugëve kombëtare. Në territorin e sajë ka edhe një bregdet që mbetet ende i pashfrytëzuar, ku ofrohen resurse mjaft të përshtatshme për zhvillimin e turizmit (Plazhi dhe luguna e Patokut dhe Plazhi i Adriatikut)..

7.1.3. Tokat

Tokat në këtë zonë janë të hinjta kafe dhe të kafenjta. Ato shtrihen në formën e brezave vertikale deri në lartësitë më të mëdha të zonës.

7.1.4. Ujërat

Rrjeti hidrografik kryesor në zonën në studim që furnizon në mënyrë të pandërprerë shtresën nëntokësore të zhavorreve është lumi i Matit. Ai ka një gjatësi 144 km, sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës rreth 2 441 km² dhe lartësi mesatare të pellgut rreth 746 m. Degët kryesore të tij janë Fani dhe Uraka. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Mat në derdhje në det është 103 m³/sek, me koeficient të rrjedhjes për të gjithë pellgun ujëmbledhës 0,80. Ushqimi nëntokësor përfaqëson 30% të rrjedhjes vjetore dhe ai sipërfaqësor (nga rreshjet e shiut e borës) 70%. Vëllimi i aluvioneve pezull është mbi 2 milion ton, ndërsa moduli i aluvioneve pezull është 828 ton/km² në vit.

7.1.5. Klima

Në territorin e Bashkisë së Kurbinit mbizotëron klima mesdhetare, me bregdet, fusha pjellore, kodrina të ulëta, vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit dhe pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore, ndërsa në zonën malore bie dëborë në dimër. Trashësia mesatare e dëborës shkon mesatarisht deri në 50 cm. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve, që si rezultat i ngritjes së nivelit të shtratit të lumit Mat nga ndërtimi i baseneve të hidrocentraleve ku shpejtësia e tyre arrin deri në 100 km/h sidomos në periudhën e dimrit. Nga pikëpamja e temperaturave vërehen amplituda të mëdha midis dimrit dhe verës. Temperatura mesatare vjetore është 15.6 gradë celcius, kurse amplituda mesatare është 18 gradë celcius. Reshjet në territorin e bashkisë kanë një shpërndarje të pabarabartë. Sasia mesatare e reshjeve është 1350 mm në vit. Në zonën malore, kryesisht aty ku bie dëborë në dimër, reshjet janë të pranishme edhe gjatë verës, kurse

në zonën kodrinore dhe fushore vera është e thatë. Ditët me diell variojnë nga 220-240 dite, ku mesatarisht gjatë vitit ka deri 3000 orë diell.

7.2. Mjedisi biologjik

Zona e projektit gjendet në fshatin Gurrëz, dhe kufizohet shtratin e lumit Mat në veri, i cili pranë grykëderdhjes në detin Adriatik, zgjerohet deri në 1 km. Ndërkohë në krahun jugor dhe jug-perëndimor kufizohet me kënetën e Patokut. Si e tillë, kjo sipërfaqe përfshin një diversitet të pasur dy lloje habitatesh, si:

- Toka me bar gjysëm natyrore;
- Toka bujqësore;

Ndërkohë, ajo kufizohet dhe me mjedise të tjera natyrore, të cilat luajnë rol të rëndësishëm duke shtuar vlerën botanike të zonës, si dhe numrin e llojeve faunistikë, që megjithëse nuk janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejt me zonën e projektit, e vizitojnë atë në kërkim të ushqimit, vendeve për folezim, ose e përdorin atë si rrugë kalimi. Konkretisht zona kufizohet me:

- Pyjet alluvial përgjatë brigjeve të lumit Mat;
- Habitatin e tokaveve të lagështa (pellgje me ujë të ndenjtur).

7.2.1. Flora

Në procesin e inventarizimit dhe përcaktimit të shoqërimeve bimore është përdorur *metodika e arealit minimum*, e cila konsiston në inventarizimin e llojeve të sipërfaqes bimore, brenda së cilës nuk ka dallime të theksuara të përbërjes floristike. Numri më i madh i llojeve është përcaktuar direkt në terren, ndërkohë llojet e panjohura janë vendosur në herbar dhe janë përcaktuar në mjedisin e punës duke u bazuar në librin “Flora Ekskursioniste e Shqipërisë”, si dhe studime të tjera në afërsi të zonës në studim. Habitatet dhe llojet janë dokumentuar nëpërmjet fotografive të bëra në terren. Ndërkohë, krahas interpretimit, të dhënat e mbledhura në terren janë hedhur në data – bazë (emërtimi në latinisht dhe shqip, lista e llojeve në varësi të habitatit, statusi, prezenca). Për përcaktimin e statusit të llojeve i kemi referuar listës sipas Urdhërit nr. 1280, datë 20.11.2013, “Për miratimin e listës së kuqe të Florës dhe Faunës së egër”, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 22 të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

7.2.2. Fauna

Bazuar në vrojtimit në terren, në botimet e publikuara për zonat në afërsi, si dhe në kërkesën e llojit për habitat, vlerësohet se në zonën në studim gjenden 84 lloje vertebrorë, ku përfshihen amfibë, reptilë, shpendë dhe gjitarë. 10 lloje vertebrorësh u vrojtuan në terren gjatë monitorimit. Ndërkohë, vlerësohet së në bazë të kërkesës së llojit për habitat, shpërndarjes gjeografike dhe ekologjisë së llojeve, në zonën e marrë në studim mund të gjenden edhe 89 lloje të tjera. Nga totali i kafshëve të evidentuara, 11 lloje janë me status të ekspozuar ndaj rrezikut (VU), 6 lloje janë me status në rrezik (EN), 8 lloje janë vlerësuar me rrezik të ulët (LR), 1 lloj është i kërcënuar në mënyrë kritike (CR) dhe për 5 lloje nuk ka të dhëna të sakta

7.2.3. Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Nga verifikimi rezulton se pranë zonës së përzgjedhur për ushtrimin e aktivitetit nuk ka monumente natyre.

Prona objekt vleresimi ndodhet në nenonimin Përdorimi Tradicional brenda Hartes së Zonës së Mbrojtur Rezervat Natyror i Menaxhuar (Kategoria e IV).

8. PERSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR

8.1. Analiza e ndikimeve të mundshme sociale dhe në mjedis

Analiza e ndikimeve shërben për të parashikuar ndikimet e mundshme të projektit në mjedis si dhe vlerësuar shkallën/rëndësinë apo madhësinë e tyre në raport me vlerat mjedisore që dëmtohen nga ndikimet. Rëndësia e çdo ndikimi apo pasoja e tij në receptorin apo zonën e ndikuar është vlerësuar dhe kategorizuar bazuar në probabilitetin që ndikimi të ndodhë, llojin i ndikimit, kohëzgjatjen e ndikimit, shkallën e ndikimit dhe mundësinë për të zbutur pasojat e ndikimit.

8.2. Ndikimet në mjedis të projektit të propozuar për trajtimin e mbetjeve

Ndikimet e mundshme në mjedis të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore janë të lidhura vetëm me fazën e zhvillimit të veprimtarisë. Trajtimi i mbetjeve spitalore me një nga teknologjitë standarte dhe të aprovuara e të certifikuara në kushtet kur aktualisht administrimi i tyre bazuar në kërkesat ligjore është pothuajse inekzistent, pritet të ketë më shumë pasoja të karakterit pozitiv.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e ndikimeve që mund të shkaktohen nga zhvillimi i veprimtarisë së propozuar ndërsa në paragrafët e mëposhtëm bëhet një analizë më e detajuar e tyre.

Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis					
Mjedis i pritës	Përshkruaj	Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis	Shtirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla)	Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe indirekte)	Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj)
Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së veprimtarisë	Nuk ka sepse nuk ka ndërtime apo punime të hapura dhe masive.veprimtaria është egzistuese .	N/A	N/A	N/A	Objekti në të cilin do të instalohet impianti i ri është egzistues me të njëjten fushe aktiviteti
Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së	Nuk ka. Veprimtaria do të zhvillohet në një objekt ekzistues dhe përdor teknologji që nuk shkarkon	N/A	N/A	N/A	Magazina është egzistuese dhe është legalizuar vitin e fundit

veprimtarisë	në mjedis dhe sherben per permiresimin e ambjentetit .				
Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve	Mbetjet mbasi të trajtohen do të magazinohen, transportohen dhe depozitohen në mënyrë të sigurtë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Ky aktivitet ndikon në uljen e presionit nga mbetjet	N/A	N/A	N/A	Zbatimi i aktivitetit do të ketë monitorim edhe nga AKZM
Ndikimet negative shitesë (kumulative) në cilësinë e mjedisit dhe burimet natyrore si mineralet, pyje, burimet ujore në zonën e veprimtarisë	Nuk ka. Teknologjia e propozuar e trajtimit të mbetjeve nuk shoqërohet me shkarkime në mjedis dhe njëkohësisht parandalon ndotjen dhe dëmtimin e mjedisit nga mostrajtimi i mbetjeve	N/A	N/A	N/A	N/A
Ndikimet sociale të projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet si përdorimi i burimeve natyrore etj.)	Nuk ka. Objekti është ekzistues.	N/A	N/A	N/A	N/A
Në varësi të natyrës të projektit një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis	Procese që ekspozon pasoja në mjedis janë operacionet e transportit dhe paratrajtimit dhe mosrespektimit të teknologjise . Të tilla përfshijnë dëmtimin e kontenierëve dhe qeseve të grumbullimit të mbetjeve dhe derdhjen e mbetjeve në mjediset e spitaleve, gjatë rrugës apo në ambjentet e magazinimit. Aksitende të mundshme	Analitik/ logjik	E lokalizuar	Direkte / indirekte	Ambjentet e punës në qendrat shëndetësore dhe në ambjentet e magazinimit

	jane rena e zjarrit dhe perballimi i nje rast permbytyje natyrore.				
Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit (nëse ka të tilla)	Nuk ka pasi zona ku do te zhvillohet projekti eshte ne brendezi te territorit te republikes se Shqiperise	N/A	N/A	N/A	N/A
Ndikimet pozitive në mjedis	Do të shmangë rrezikun e ndotjes së mjedisit nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik. Ndotja e mjedisit nga mbetjet e rrezikshme spitalore është një shqetësim madhor për Shqipërinë.	Perputhja e trajtimit me standartet	Referuar territorit qe do mbulojne kontratat e sherbimit	N/A	N/A
Ndikimi social	Ndikimet sociale të projektit janë me kah pozitiv. Shërbimet e ofruara nëpërmjet kontratave te sherbimit rrisin sigurinë shëndetësore e sociale. Ndotja e mjedisit nga mbetjet spitalore përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe është një shqetësim madhor për Shqipërinë.	Përputhja e trajtimit me standartet Përmirësimi sigurisë së shëndetit publik dhe mjedisor	Referuar territorit qe do mbulojne kontratat e sherbimit	N/A	N/A

N/A – nuk aplikohet (ska ndikim)

Ndikimet e mundshme sipas operacioneve jepen në tabelën e mëposhtme.

Operacioni	Ndikimi i mundshëm në mjedis
Marrja e mbetjeve nga spitalet/klinikat/qendra të kujdesit shëndetësor etj., ku ato prodhohen .	Gjatë ngarkimit në mjet punonjesit mund të infektohen apo dëmtohen për shkak të kontaktit direkt me mbetjet spitalore përfshi edhe ato të mprehta (etj)
Ruajtja apo depozitimi i përkohshëm i mbetjeve para trajtimit	Është e kuptueshme që sasia e mbetjeve spitalore që vijnë në objekt nuk është e njëjtë me atë që trajtohet gjatë një cikli. Kjo do të thotë që në çdo kohë në mjediset e qendrës mund të lindë nevoja për magazinim të përkohshëm të mbetjeve. Nëse mbetjet nuk ruhen të ambalazuara dhe në kontenerë plastikë apo metalikë që nuk lejojnë rrjedhjet e lëngjeve që përmbajnë mbetjet, ekziston mundësia që sasi minimale lëngjesh të derdhen në zonën e ruajtjes së mbetjeve para – trajtimit duke shkaktuar ndotje me agentë infective dhe ndotje te tokes.

Trajtimi me djegie	Nëse nuk përdoren mjetet e posaçme të punës për ngarkimin e mbetjeve në impiant, punonjësit mund të infektohen apo dëmtohen për shkak të kontaktit direkt me mbetjet me rrezik biologjik, përfshi edhe ato të mprehta (si aget, bisturi etj.).
	Nese nuk kemi rregullim te sasise se ajrit qe duhet per zhvillimin normal te procesit te djegies si edhe pastrim periodik te filtrave do te kemi shkarkime te tymit te zi me permbajte te CO, dioksinave, okside te metaleve te renda, NOx dhe komponime te sqfurit.
Ruajtja dhe depozitimi i përkohshëm pas –trajtimit i produkteve përfundimtare	Ruajtja do të bëhet në ambalazhe të posaçme qe nuk lejojne asnjë mundësi ndotje në mjedis.
Transporti dhe depozitimim final në venddepozitimim e përcaktuar	Tansporti do të bëhet direkt në venddepozitimim e përcaktuar me ane te automjeteve te posacme. Mbetjet pas procesit të trajtimit do të jenë të ambalazuara në qeset e posaçme. Per ne depozitimim final .

Siç shihet nga matrica e mësipërme, ndikimet në mjedis të teknologjisë së propozuar janë minimale dhe kjo është edhe një nga përparësitë e metodës së zgjedhur, krahasuar me metodat e tjera të trajtimit të mbetjeve spitalore.

- Ndikimet e vetme të trajtimit me sistemin e zgjedhur përfshijë emetimet e mundshme në ajër të aromave dhe shkarkimet aksidentale si rezultat i transportit dhe paramagazinimit të tyre në pritje të trajtimit si edhe gjate procesit te djegies ne restet kur nuk kemi djegie normale dhe pastrim periodik te filtrave.
- Ne lidhet me shkarkimet e lëngëta, nuk kemi perdorim te ujit ne procesin e zgjedhur per asgjesimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore;
- Ndikimet e mundshme/aksidentale gjatë operacioneve të transportit kanë si burim kryesor pakujdesinë dhe moszbatimin e protokollit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve spitalore.

8.3. Ndikimet sociale të projektit të propozuar për trajtimin e mbetjeve

Asgjesimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore mbi të gjitha ndihmon në krijimin e një impakti social pozitiv të shërbimit shëndetësor dhe në vetë shërbimin shëndetësor. Në kushtet kur menaxhimi sipas kërkesave ligjore dhe standarteve i mbetjeve spitalore është pothuajse inekzistent, trajtimi i tyre nëpërmjet njërës prej teknologjive më bashkëkohore dhe miqësore me mjedisin do të shmangë rrezikun që këto mbetje paraqesin për mjedisin dhe shëndetin. Shërbimet e projektit rrisin sigurinë shëndetësore dhe ulin barrën e ndotjes mjedisore dhe pasojave sociale të saj (sëmundjet, dëmtimi i burimeve natyrore, nevoja për financime për rehabilitim mjedisor).

Në këtë kontekst ndikimet sociale të veprimtarisë kanë karakter pozitiv dhe përfshijnë:

1. Trajtimin e një fraksioni të caktuar të mbetjeve spitalore, në përputhje me politikat dhe kuadrin ligjor përkatës kombëtar dhe europian dhe standartet.
2. Ofron zgjidhje konkrete në drejtim të menaxhimit të mbetjeve spitalore duke i dhënë fund rrezikut që ato përbëjnë për popullatën dhe shëndetin në kushte të groposjes së tyre të patrajtuara në vendepozitime të mbetjeve urbane, shpesh edhe pranë qendrave të banuara.
3. Propozon një ndër metodat bazë të trajtimit të mbetjeve spitalore në të gjithë botën, aprovuar dhe çertifikuuar nga organizmat ndërkombëtarë.

9. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

Do të shmangë rrezikun e ndotjes së mjedisit nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet kontratave të shërbimit, ulin barrën e ndotjes mjedisore dhe pasojave, dëmtimi i burimeve natyrore, nevoja për financime për rehabilitim mjedisor.

Ndotja e mjedisit nga mbetjet e rrezikshme sidomos ato spitalore përbejne një shqetësim madhor për Shqipërinë dhe implementimi i këtij projekti do të ndikojë në zvogelimin e këtij ndikimi.